



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 157

Tiranë – E mërkurë, 9 gusht 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Urdhër i ministrit të Financave nr. 94, datë 3.8.2017	Për delegim kompetence..... 7361
Urdhër i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave nr. 254, datë 3.8.2017	Për delegim kompetencash..... 7361
Urdhër i ministrit të Punëve të Brendshme nr. 817, datë 4.8.2017	Për delegimin e kompetencave..... 7361
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 43, datë 2.8.2017	Për dhënien e miratimit paraprak për kryerjen e veprimtarisë financiare shtesë nga Banka Credins sh.a..... 7362
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 109, datë 27.7.2017	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Alin Trading” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike..... 7362
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 110, datë 27.7.2017	Mbi miratimin e “Rregullores për përcaktimin/klasifikimin e sistemeve të mbyllura të shpërndarjes së energjisë elektrike”..... 7363
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 111, datë 27.7.2017	Mbi mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë RTS sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike..... 7365
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 112, datë 27.7.2017	Mbi rishikimin e programit të transparencës së ERE-s..... 7367
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 113, datë 27.7.2017	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit OST sh.a. në aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike..... 7378
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 114, datë 27.7.2017	Mbi licencimin e shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k. në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike..... 7379

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 115, datë 27.7.2017	Për miratimin e rregullave për garancitë financiare të pjesëmarrësve për regjistrimin në tregun e energjisë elektrike.....	7380
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 116, datë 27.7.2017	Mbi kërkesën për rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 148, datë 26.12.2014, për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë për vitin 2015.....	7382
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 117, datë 27.7.2017	Mbi kërkesën e shoqërisë OSHEE sh.a. për miratimin e përfundimit të kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike me shoqërinë “Star NRG” sh.p.k., në mënyrë të njëanshme.....	7383
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 119, datë 27.7.2017	Mbi licencimin e shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k. në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike.....	7384
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 120, datë 27.7.2017	Mbi përcaktimin e çmimeve të blerjes së energjisë elektrike, të prodhuar nga burimet e vogla gjeneruese fotovoltaike, me kapacitet të instaluar deri në 2 MW, dhe eolike me kapacitet të instaluar deri në 3 MW.....	7385

**URDHËR****Nr. 94, datë 3.8.2017****PËR DELEGIM KOMPETENCE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të neneve 28, 29 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 6 të ligjit nr. 9000, datë 30.12.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të nenit 11 të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Financave, zëvendësministrit të Ministrisë së Financave, z. Erjon Luçi. Kompetencat e titullarit të Ministrisë së Financave do të ushtrohen për periudhën 3.8.2017 deri më 17.8.2017.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Ministrisë së Financave, z. Erjon Luçi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Helga Vukaj

URDHËR**Nr. 254, datë 3.8.2017****PËR DELEGIM KOMPETENCASH**

Në mbështetje të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për Arkivat”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 11, pikave 2 dhe 3 të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, z. Endri Musai, Drejtor i Inspektimit dhe Trajnimit, për shkak të mungesës me arsye të titullarit të këtij institucioni.

2. Kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave do të ushtrohen për periudhën nga data 7.8.2017 deri në datën 20.8.2017.

3. Nuk delegohen kompetencat e drejtuesit lidhur me personelin, si dhe kompetencat e tjera të padelegueshme, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

4. Për veprimet e kryera në zbatim të këtij urdhri, Drejtori i Inspektimit dhe Trajnimit do të ruajë kopje të kartelave shoqëruese të praktikave shkresore të iniciuara apo përfunduara prej tij, së bashku me afatet e përcaktuara dhe ecurinë e mbarëvajtjen e çështjeve, dhe do t’ia bëjë të ditura titullarit me rikthimin e tij në detyrë.

5. Për zbatimin e urdhrit ngarkohet Drejtori i Inspektimit dhe Trajnimit, z. Endri Musai.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM
Ardit Bido

URDHËR**Nr. 817, datë 4.8.2017****PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të nenit 29 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e plotë të kompetencave të titullarit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, zëvendësministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, znj. Rovena Voda, nga data 7.8.2017 deri më datë 25.8.2017.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme, znj. Rovena Voda.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
Dritan Demiraj



VENDIM

Nr. 43, datë 2.8.2017

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT
PARAPRAK PËR KRYERJEN E
VEPRIMTARISË FINANCIARE SHITESË
NGA BANKA CREDINS SHA**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja “e”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 194, pika 4 dhe nenit 204, pika 4 të ligjit nr. 52/2014, datë 22.5.2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, nenit 23, pikat 1 dhe 3, të nenit 24, pika 1, shkronja “ç”, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 18, pika 8 të rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 14, datë 11.3.2009, e ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraprak për kryerjen nga Banka Credins sh.a. të veprimtarisë financiare shtesë të ndërmjetësimit në sigurime.

2. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë për të bërë ndryshimet përkatëse në aneksin e licencës të Bankës Credins sh.a., pas paraqitjes së licencës së dhënë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Gent Sejko**

VENDIM

Nr. 109, datë 27.7.2017

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALIN
TRADING” SHPK NË AKTIVITETIN E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “e”; 5, pika 1, germa “e”; 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe nenit 19, pika 1, germa “a” e “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.7.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Alin Trading” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Shoqëria “Alin Trading” sh.p.k., me shkresën e datës 28.6.2017, protokolluar në ERE me nr. 485 Prot., datë 28.6.2017, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

Aplikimi i shoqërisë “Alin Trading” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Alin Trading” sh.p.k. në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ANËTARI I BORDIT TË ERE-S
Adriatik Bego

VENDIM

Nr. 110, datë 27.7.2017

**MBI MIRATIMIN E “RREGULLORES
PËR PËRCAKTIMIN/KLASIFIKIMIN E
SISTEMEVE TË MBYLLURA TË
SHPËRNDARJES SË ENERGISË
ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 71 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.7.2017, mbasi shqyrtoi relacionin mbi “Rregulloren për përcaktimin/klasifikimin e sistemeve të mbyllura të shpërndarjes së energjisë elektrike”, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike, konstatoi:

- ERE me vendimin nr. 105, datë 23.6.2016, ka filluar procedurat për miratimin e “Rregullore për përcaktimin/klasifikimin e sistemeve të mbyllura të shpërndarjes së energjisë elektrike” dhe ka realizuar procesin e konsultimit me palët e treta në përputhje me legjislacionin në fuqi.

- Me shkresën, nr. 26/34 Prot., datë 25.6.2016, ERE publikoi për 3 ditë me radhë në median e shkruar njoftimin për vendimmarrjen e sipërcituar të bordit, duke filluar nga data 25.6.2016.

- Po ashtu me shkresën nr. 500 Prot., datë 30.6.2016, ERE dërgoi draftregulloren për përcaktimin/klasifikimin e sistemeve të mbyllura të shpërndarjes së energjisë elektrike, për marrje mendimi, pranë subjekteve: Autoriteti Portual i Durrësit, MEI, Autoriteti i Konkurrencës, Albpetrol sh.a., FIJA, AREA dhe AAES.

- Pas përfundimit të afatit 15-ditor të marrjes së mendimeve nga palët e interesuara rezultoi se janë paraqitur në ERE mendime nga Autoriteti i Konkurrencës, Autoriteti Portual i Durrësit dhe Albpetrol sh.a.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë “Rregulloren për përcaktimin/klasifikimin e sistemeve të mbyllura të shpërndarjes së energjisë elektrike”.

2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ANËTARI I BORDIT TË ERE-S
Adriatik Bego

**RREGULLORE PËR
PËRCAKTIMIN/KLASIFIKIMIN E
SISTEMEVE TË MBYLLURA TË
SHPËRNDARJES SË ENERGISË
ELEKTRIKE**

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Autoriteti**

Kjo rregullore hartohet në zbatim të nenit 71 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” si dhe në përputhje me nenin 25 të Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s.

**Neni 2
Qëllimi i rregullore**

Kjo Rregullore përcakton kushtet dhe procedurat që zbatohen nga ERE për klasifikimin e



një sistemi shpërndarje si sistem i mbyllur, formën e aplikimit, dokumentacionin mbështetës që shoqëron aplikimin, mënyrën e mbajtjes së regjistrit të sistemeve të mbyllura, si dhe kushtet dhe procedurat për revokimin e statusit si sistem i mbyllur i shpërndarjes.

Neni 3 Përkufizime

“Enti Rregullator i Energjisë” - ose “ERE” është autoriteti rregullator i sektorëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror, i cili funksionon në përputhje me ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe ligjin nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”.

“Bordi” - është organi vendimmarrës i ERE-s.

“Sistemi i mbyllur i shpërndarjes” - është një sistem i cili shpërndan energji elektrike brenda një zone gjeografikisht të kufizuar industriale, tregtare apo shërbimesh të përbashkëta, nga i cili nuk shpërndahet energji për klientët familjarë ose klientët jofamiljarë të vegjël dhe nëse:

a) për arsye të veçanta teknike apo të sigurisë, veprimtaritë ose proceset e prodhimit të përdoruesve të këtij sistemi janë të integruara; ose

b) ky sistem shpërndan energji elektrike kryesisht te pronari, tek operatori i sistemit të mbyllur apo shoqëri të lidhura me të.

“Operatori i Sistemit të mbyllur të shpërndarjes” – është operatori që ushtron aktivitetin sipas licencës për sistemin e mbyllur të shpërndarjes dhe rregullave përkatëse të funksionimit të miratuara nga ERE.

Neni 4

Kushtet për klasifikimin e sistemit të mbyllur të shpërndarjes

1. Sistemi i mbyllur i shpërndarjes duhet të plotësojë këto kushte:

a) Asetet fizike të shpërndarjes së energjisë elektrike në zonë të jenë në pronësi të personit që aplikon për klasifikimin si sistem i mbyllur i shpërndarjes.

b) Të ketë një pikë lidhjeje dhe matje të përcaktuar në marrëveshjen e lidhjes me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.

c) Numri i klientëve të lidhur me sistemin e mbyllur të shpërndarjes të mos jetë jo më i vogël se XX dhe jo më i madh se XX ose sasia e

energjisë elektrike e konsumuar gjatë një viti nga konsumatorët në territorin e mbuluar nga sistemi i mbyllur i shpërndarjes, nuk duhet të kalojë ...% të konsumit vjetor total të të gjithë klientëve në vend.

2. Në rast se sistemi i mbyllur i shpërndarjes nuk kërkon përjashtimin e tij sipas pikës 2 të nenit 71, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nga rregullimi i tarifave nga ERE, tarifat e aplikueshme për klientët e lidhur në sistemin e mbyllur do të shqyrtohen dhe do të miratohen nga ERE, në përputhje me nenin 21 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

KREU II PROCEDURAT E APLIKIMIT

Neni 5

Dokumentacioni për klasifikimin e sistemit të mbyllur të shpërndarjes

1. Aplikimi për klasifikim në sistemin e mbyllur të shpërndarjes do të depozitohet në ERE nga aplikuesi i interesuar.

2. Në formatin e tij të aplikimit, aplikuesi do të shprehë interesin për t’u klasifikuar si operator i sistemit të mbyllur të shpërndarjes.

3. Përveç formës së aplikimit nevojitet dorëzimi i dokumentacionit të mëposhtëm shtesë për përmbushjen e kushteve për klasifikimin në sistemin e shpërndarjes:

a) Ekstrakt nga QKR-ja i shoqërisë tregtare, ku vërtetohet se është e regjistruar në aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike.

b) Studimi Gjeodezik së bashku me një ekstrakt të planit kadastral me veçoritë e mëposhtme:

- projekti teknik i instalimeve;

- skicat dhe emërtime të instalimeve, linjave, transformatorëve nga pika e lidhjes në sistemin e transmetimit dhe i shpërndarjes, deri tek pika e lidhjes së përdoruesve të sistemit, duke përfshirë emërtimet e pikave të matjes;

- skicat e instalimeve të nevojshme për funksionimin e sistemit të mbyllur të shpërndarjes, dhe

- skica e infrastrukturës së përdoruesit të sistemit të mbyllur të shpërndarjes prej të cilit mund të përcaktohet saktësisht që është një zonë gjeografikisht e kufizuar;



- harta treguese e zonës gjeografike që mbulohet;

c) Dokumenti që vërteton pronësinë e infrastrukturës sipas pikës 3, germa b).

d) Pronësia mbi asetet fizike të shpërndarjes.

e) Leja e ndërtimit të rrjetit.

f) Kopje të lejeve të përdorimit dhe dokumenteve të tjera për energjinë, si dhe pajisje të tjera në dobi për klasifikimin e sistemit të mbyllur të shpërndarjes. Për pajisjet e amortizuara, të cilat nuk kanë lejen e përdorimit, nevojitet një vlerësim nga inspektorë kompetentë në fushat, si: sektori i energjisë elektrike, efienca e energjisë elektrike, mbrojtja ndaj zjarrit dhe shpërthimeve, si dhe mbrojtja ndaj ambientit.

g) Një listë të përdoruesve të sistemit të mbyllur të shpërndarjes me numrin identifikues të pikës së lidhjes.

h) Përshkrimi i mënyrës në të cilën puna apo prodhimi, tregtimi apo aktiviteti i shërbimit të përdoruesit të sistemit të mbyllur të shpërndarjes do të integrohet për shkak të arsyeve teknike apo të sigurisë dhe/ose prova që sistemi i shpërndan elektricitet pavarësisht pronarit/zotëruesit apo operatorit të sistemit, apo sipërmarrësve të lidhur me to.

i) Përshkrimi specifik i sistemit të mbyllur të shpërndarjes.

j) Përshkrimi ekonomik i sistemit tregtar apo i shërbimeve të zonës gjeografike të kufizuar ndaj së cilës operatori i sistemit të mbyllur të shpërndarjes do të kryejë aktivitetin.

k) Një vërtetim të personave përgjegjës të cilët përfaqësojnë aplikuesin, ku deklarojnë se marrin përsipër detyrimin për të ndarë llogarinë e aktivitetit të shpërndarjes në sistemin e mbyllur nga llogaritë e aktiviteteve të tjera në sektorin e energjisë elektrike.

l) Një vërtetim nga personat përgjegjës që përfaqësojnë aplikuesin, të lëshuar nga autoriteti kompetent inspektues ku konstatohet se nuk ka asnjë pengesë në mënyrën e operimit të pajisjeve dhe instalimeve që përbëjnë sistemin e mbyllur të shpërndarjes.

m) Një vërtetim që i deleguari përgjegjës nuk është përfshirë në një proces të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata).

n) Vërtetimin e pagesës rregullatore nga aplikanti në momentin e paraqitjes së aplikimit, siç përcaktohet nga ERE.

Neni 6

Operator i sistemit të mbyllur të shpërndarjes

1. Operimi i një sistemi të mbyllur të shpërndarjes mund të bëhet nga subjekti ose personi pronar i sistemit të mbyllur të shpërndarjes ose nga një person i tretë i autorizuar ose i kontraktuar nga ai.

2. Personi që merr përsipër operimin e sistemit të mbyllur të shpërndarjes duhet të pajiset me licencë shpërndarje nga ERE. Kushtet e licencës së një operatori të sistemit të mbyllur të shpërndarjes përcaktohen në Rregulloren e Licencimit të ERE-s dhe janë në zbatim të standardeve teknike dhe kërkesave të Kodit të Shpërndarjes.

3. Operatori i sistemit të mbyllur të shpërndarjes është përgjegjës për disbalancat ashtu si edhe çdo operator i tregut të energjisë elektrike.

Neni 8

Amendime të rregullores

Këto rregulla janë objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të bordit të ERE-s.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit të saj nga bordi i ERE-s.

VENDIM

Nr. 111, datë 27.7.2017

MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË RTS SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a”; 7 dhe 10, pika 2 dhe 7 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullave për organizimin,



funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2017; VKM-në nr. 822, datë 7.10.2015, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike që nuk janë objekt koncesioni”, të ndryshuar, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.7.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë RTS sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Dokumentacioni i depozituar në ERE nga shoqëria RTS sh.p.k., në bazë të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, rezulton:

Formati dhe dokumentacioni për aplikim është plotësuar nga aplikanti si më poshtë:

Neni 9, pika 1:

- germa “a” (të dhënat për aplikim), germa “b” (të dhëna identifikuese për aplikuesit) germa “c” (të dhëna për aplikuesin) plotësuar.

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor është plotësuar nga aplikanti si më poshtë:

Neni 9, pika 2:

- germat “a”/“b” (akti i themelimit/statuti) plotësuar;

- germa “c” (vërtetimi i regjistrimit nga QKB) plotësuar;

- germa “d” (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë) pa plotësuar;

- germa “f”, subjekti nuk ka paraqitur autorizim të lëshuar nga MEI në lidhje me ushtrimin e këtij aktiviteti;

- germa “g”, subjekti ka paraqitur marrëveshje me bashkinë Devoll (kontrata shitblerje, kontrata qiraje, akte dhurimi, kontrata premtimi), për zonën ku do të shtrihet projekti i ndërtimit.

Dokumentacioni financiar dhe fiskal është plotësuar nga aplikanti si më poshtë:

Neni 9, pika 3:

- germa “a” (vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave), subjekti nuk ushtron aktivitet tregtar, për rrjedhojë nuk ka detyrime ndaj tatim-taksave;

- germa “b” (bilanci financiar i tre viteve të fundit), subjekti është themeluar më datë 5.6.2017,

për rrjedhojë nuk mund të disponojë bilanc financiar;

- germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit) pa plotësuar;

- germa “d” (vërtetimin e pagesës së regjistrimit për aplikim në llogari të ERE-s) pa plotësuar.

Dokumentacioni teknik për centralet SOLARE

Neni 9, pika 4.1 - Të dhënat teknike për centralet SOLARE, plotësuar.

Neni 9, pika 4.2 - Të dhënat teknike për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin, plotësuar.

Neni 9, pika 4.3 - Dokumentacioni teknik dhe grafik, plotësuar.

Neni 9, pika 4.4 - Dokumentacioni tekniko - ekonomik, pa plotësuar.

Neni 9, pika 4.5 - Leje nga institucione të tjera, pa plotësuar.

Kërkesa e paraqitur nuk plotëson kushtet e një aplikimi, në përputhje me formën, përmbajtjen, afatet dhe përcaktimet e kësaj rregulloreje.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Mosfillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë RTS sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me fuqi të instaluar 2 MW.

2. Nëse aplikuesi paraqet aplikimin e ri në përputhje me “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” brenda 1 muaji nga marrja e këtij vendimi, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin do të konsiderohet i vlefshëm për aplikimin e ri.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ANËTARI I BORDIT TË ERE-S

Adriatik Bego



VENDIM

Nr. 112, datë 27.7.2017

**MBI RISHIKIMIN E PROGRAMIT TË
TRANSPARENCËS SË ERE-S**

Në mbështetje të nenit 16 ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe nenit 4 dhe 5 pika 2 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, nenit 6 të ligjit 120/2014 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, vendimit nr. 4, datë 19.6.2017, të Këshillit të Lartë të Arkivave “Për miratimin e rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”; bordi i anëtarëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.7.2017, mbasi dëgjoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për rishikimin e programit të transparencës, miratuar me vendimin nr. 69, datë 11.5.2015, “Për miratimin dhe zbatimin e programit të transparencës së ERE-s”, të bordit të komisionerëve të ERE-s,

konstatoi se:

- Enti Rregullator i Energjisë është autoritet publik në kuptim të nenit 10, pika 1 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë Elektrike”, si dhe nenit 2, pika 1 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 69, datë 11.5.2015, ka vendosur: miratimin dhe zbatimin e programeve të transparencës së ERE-s parashikuar në nenin 4 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

- Neni 5 i ligjit “Për të drejtën e informimit”, pika 2 parashikon që:

2. Afatet për rishikimin e programit të transparencës mund të ndryshojnë në varësi të natyrës së çdo autoriteti publik, por, në asnjë rast, nuk mund të jenë më të gjata se 5 vjet.

- Me vendimin nr. 4, datë 19.6.2017, “Për miratimin e rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”, të Këshillit të Lartë të Arkivave, janë përcaktuar procedurat që duhet të zbatohen autoritetet publike në përputhje me normat tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, si dhe udhëzime për klasifikimin, sistemimin, përshkrimin, ruajtjen dhe restaurimin e dokumenteve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Rishikimin e programit të transparencës së ERE-s (bashkëlidhur programi).

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për implementimin e programit të transparencës sipas këtij vendimi e lidhjeve bashkëngjitur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ANËTARI I BORDIT TË ERE-S
Adriatik Bego

**PROGRAMI I TRANSPARENCËS SË
ERE-S**

Lidhja nr. 1

Programi i Transparencës për ERE-n, ku parashikohet:

- i) korniza ligjore e veprimtarisë së Autoritetit;
- ii) parimet e përgjithshme;
- iii) informacioni që bëhet publik pa kërkesë;
- iv) tabela përmbledhëse e programit të transparencës;
- v) publikimi;
- vi) monitorimi.

Lidhja nr. 2

“Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve” dhe “Regjistri i kërkesave/ankesave të konsumatorëve dhe përgjigjeve”, ku paraqitet formati i regjistrit dhe veprimet mbi të.

Lidhja nr. 3

“Kërkesë për informacion”, në cilësinë e shkresës kërkuese që mund të paraqitet nga çdo subjekt i interesuar për marrje informacioni nga Autoriteti publik.

–“Përgjigja”, në cilësinë e shkresës përgjigjëse nga Autoriteti publik.

Lidhja nr. 4/a

“Refuzimi i formës së kërkuar të informacionit/dokumentacionit”, në cilësinë e dokumentit të refuzimit të kërkesës.

Lidhja nr. 4/b

“Zgjatja e afatit të kthimit të përgjigjes”, në cilësinë e dokumentit mbi zgjatjen e afatit të kthimit të përgjigjes nga ERE.



Lidhja nr. 4/c

“Njoftim për fillimin e procedurës për rishikim të dokumentacionit të klasifikuar dhe shtyrje të afatit”.

PROGRAMI SI MË POSHTË:

LIDHJA NR. 1

PROGRAMI I TRANSPARENCËS PËR ENTIN RREGULLATOR TË ENERGJISË

I. HYRJE

Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” është përgatitur programi i transparencës për Entin Rregullator të Energjisë. Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së autoritetit në kuadër të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”(LDI).

Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës autoriteti publik (këtej e tutje ERE) ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, nën garancinë e LDI-së. ERE do të përditësojë herë pas here Programin e Transparencës, në përputhje me pikën 2 të nenit 5 të LDI-së.

Informacioni i bërë publik në këtë program synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së ERE-s, nëpërmjet pasqyrimin të detajuar të tij në faqen zyrtare www.ere.gov.al si dhe në mjediset e pritjes së publikut. Programi i Transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike, si dhe strukturën përkatëse, e cila prodhon ose administron dokumentin.

Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menutë ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet. Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë.

Dokumentacioni i bërë publik do të jetë i përditësuar në formë e përmbajtje. Faqja zyrtare e ERE-s është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm. Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve të të dhënave etj.

Skema e publikimit paraqitet nëpërmjet tabelës përmbledhëse të evidentuar në këtë program.

II. PARIME TË PËRGJITHSHME

Parimet kryesore në të cilat mbështetet Programi Transparencës së ERE-s janë:

1. “E drejta për informim” - është e drejtë kushtetuese e parashikuar në nenin 23 të saj, e aksesueshme nga të gjithë pa asnjë përjashtim.

2. Prezumimi i publikimit maksimal të të dhënave. ERE ushtron funksione publike, për rrjedhojë informacioni që rrjedh nga veprimtaria e tij publikohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Zbatimi korrekt i ligjit dhe dispozitave ligjore që rregullojnë në mënyrë të posaçme veprimtarinë e ERE-s dhe përkatësisht: Ligji nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

4. Informacioni përshtatet në gjuhë të qartë e të kuptueshme.

5. Organ mbikëqyrës i procedurave të informimit publik është “Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale” (këtej e tutje KDIMDP).

6. Rishikimi i programit të transparencës bëhet sipas së njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi i tij.

7. Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë:

- i plotë;
- i saktë;
- i përditësuar;
- i thjeshtë në konsultim;
- i kuptueshëm;
- lehtësisht i aksesueshëm;
- i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të autoritetit publik.

III. INFORMACIONI QË BËHET PUBLIK PA KËRKESË

Informacioni i lejuar për publikim është shprehimisht i parashikuar në nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Në përputhje me këtë program transparencë të miratuar, ERE vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit www.ere.gov.al dhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e mëposhtme të informacionit:

- Strukturën organizative të autoritetit publik.
- Tekstet e plota të konventave që janë ratifikuar, të ligjeve, të akteve nënligjore, të kodeve të sjelljes, dokumente politikash, të



manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të tij dhe që prek publikun e gjerë.

- Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës.

- Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit.

- Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime.

- Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit.

- Të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave.

- Informacion për procedurat e prokurimit sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr. 125/2013, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: listën e kontratave të lidhura, shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara, informacionin për

zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme.

- Informacion për shërbimet që autoriteti i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit, një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t’i përfituar ato, informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh, çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik.

- Çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik, procedura përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të ERE-s, një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;

- ERE, gjithashtu, krijon dhe arkivon një kopje digjitale të faqes zyrtare të tij në internet, të plotësuar me informacionin që kërkohet në programin e miratuar të transparencës, si dhe për metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë.

- Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta, bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga ERE.

Informacioni i publikuar sipas kësaj skeme përditësohet sa herë ai ndryshon.



IV. TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS
(Enti Rregullator i Energjisë)

Kategoritë e informacionit publik pa kërkesë	Baza ligjore	Dokumenti /përmbajtja	Afati kohor për publikim	Mënyra e publikimit	Struktura përgjegjëse
Përshkrim i strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik	Neni 7/1/a/d	Misioni i ERE-s - Struktura e ERE-s - Kontakte të ERE-s	Vendimet hyjnë në fuqi menjëherë nëse nuk është parashikuar ndryshe në vendim.	www.ere.gov.al Home - “Për ERE”	Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Administrim Financës dhe Marrëdhënive me Jashtë
Akte ndërkombëtare ligje; akte nënligjore; dokument politikash; dokument tjetër	Neni 7/1/b	direktive of parliament and of the council of 13 july 2009 concerning common rules for the internal market in electricity and repealing directive 2003/54/ec -legjislacioni për sektorin e energjisë, - legjislacioni sekondar i ERE-s, -rregullat e tregut, -modeli i tregut, -kodet, -metodologjitë e tarifave		www.ere.gov.al .	Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit
Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës	Neni 7/1/c/g	Format kërkesë Format ankese Adresa: Bulevardi “Bajram Curri”, Rr. “Viktor Eftimiu” 1023, Tiranë; tel. +355 42 69 590; www.ere.gov.al ; e-mail erealb@ere.gov.al			Koordinatori për të drejtën e informimit
Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit	Neni 7/1/ç	Adresa: Bulevardi “Bajram Curri”, Rr. “Viktor Eftimiu” 1023, Tiranë; tel +355 42 69590; www.ere.gov.al ; e-mail erealb@ere.gov.al . Të dhënat e koordinatorit për të drejtën e informimit		Në faqen zyrtare të ERE-s në menunë “Programi i transparencës”	Koordinatori për të drejtën e informimit



Përshkrim i procedurave të zgjedhjes, kompetencave të funksionarëve të lartë dhe procedura e ndjekjes për marrjen e vendimeve	Neni 7/1/d	Anëtarët e bordit të ERE-s, zgjidhen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Rregulloria për organizimin funksionimin dhe procedurat e ERE-s		Rregullorja për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s publikohet në faqen zyrtare të ERE-s	
Mekanizmat monitorues; raporte audit; dokumentet me tregues performance	Neni 7/1/dh	Auditimi i veprimtarisë financiare të ERE-s kryhet nga ekspertë të miratuar kontabël, të cilët përzgjidhen dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi.			Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Administrim Financës dhe Marrëdhënieve me Jashtë
Buxheti	Neni 7/1/e	Burimet financiare të ERE-s përbëhen nga pagesat rregullatore dhe pagesat e licencave, të miratuara nga ERE. (neni 17/2 ligji 43/2015)			Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Administrim Financës dhe Marrëdhënieve me Jashtë
Informacion për procedurat e prokurimit.	Neni 7/1/ë	Regjistri i realizimit të Prokurimeve Publike	Menjëherë pas dërgimit të Regjistrit në APP	Në faqen e Agjencisë së Prokurimit Publik	Komisionet e procedurave të prokurimit të ngritura me urdhër të Kryetarit.
Shërbimet e autoritetit për publikun.	Neni 7/1/f	- Licenca, - trajtim, ankesash - zgjidhje mosmarrëveshjesh, - informacione, - interpretim aktesh			- Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të tregut. - Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit
Paraqitja e mendimeve në hartimin e p/akteve etj.	Neni 7/1/gj	Vendimet e ERE-s konsultohen me Sekretariatit e komunitetit të energjisë, Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, Autoritetin e Konkurrencës dhe palët e interesit.		Vendimet publikohen në faqen e web-it www.ere.gov.al	
Mbajtja e dokumentacionit nga ERE	Neni 7/1/h	Dokumentacioni i ERE-s mbahet mbështetur në ligjin nr. 9154 datë 6.11.2003 “Për arkivat”			Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Administrim Financës dhe Marrëdhënieve me Jashtë



Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligjit nr. 119/2014	Neni 7/1/i	Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve Regjistri i kërkesave/ankesave të konsumatorëve			Koordinatori për të drejtën e informimit. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit
Informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh.	Neni 7/1/k	- Licencat - aplikimet për licencë - tipat - struktura e çmimeve dhe tarifave të energjisë elektrike			-Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve. - Drejtoria e Licencave dhe Monitorimit të Tregut
Informacione të tjera të dobishme	Neni 7/1/l	Kontrata të sektorit të energjisë			Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit

V. PUBLIKIMI

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, ERE vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit www.ere.gov.al dhe në mjediset e pritjes së publikut kategoritë e mësipërme, në një menu të veçantë të titulluar: “Programi i transparencës”.

VI. MONITORIMI

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitoron zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, duke nxitur parimin e transparencës në punën e autoriteteve publike, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për çështje të së drejtës së informimit.

Komisioneri bën rekomandime për autoritetet publike, lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës.

LIDHJA NR. 2 REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. rendor (1)	Data e regjistrimit të kërkesës (2)	Objekti (3)	Data e kthimit të përgjigjes (4)	Statusi i kërkesës (5)	Tarifa (6)
1		(Përmban edhe përmbledhje të kërkesës)	(Përmban edhe përmbledhje të përgjigjes)		
2					
3					

Shënim:

Regjistri përditësohet çdo tre muaj.

- (1) Evidentohet kronologjia e kërkesave.
- (2) Evidentohet nisja e shqyrtimit të kërkesës.
- (3) Identifikohet lloji i kërkesës.
- (4) Reflektohet afati i shqyrtimit të kërkesës dhe nëpërmjet klikimit njohja me përmbledhjen e përgjigjes. (Të dhënat personale anonimizohen në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.)
- (5) Ndihmon kërkuesin për të njohur ecurinë e procesit.
- (6) Evidenton vlerat monetare për dhënie të dokumentacionit në përputhje me udhëzimet përkatëse.



LIDHJA NR. 2
REGJISTRI I KËRKESAVE/ANKESAVE TË KONSUMATORËVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Prot. ERE	Datë	Subjekti	Nr. i kontratës	Objekti i kërkesës/ ankesës	Statusi i kërkesës / ankesës në ERE	Nr. Prot. i përgjigjes së OSHEE	Tarifa
1							
2							
3							

Shënim

Regjistri përditësohet çdo tre muaj.

(1) Evidentohet kronologjia e kërkesave.

(2) Evidentohet nisja e shqyrtimit të kërkesës.

(3) Identifikohet lloji i kërkesës.

(4) Reflektohet afati i shqyrtimit të kërkesës dhe nëpërmjet klikimit njohja me përmbledhjen e përgjigjes.

(Të dhënat personale anonimizohen në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”)

(5) Ndihmon kërkuesin për të njohur ecurinë e procesit.

(6) Evidenton vlerat monetare për dhënie të dokumentacionit në përputhje me udhëzimet përkatëse.

LIDHJA NR. 3 (kërkesa)
KËRKESË PËR INFORMACION

Emër Mbiemër ¹ : z./znj. _____	Adresa postare: _____ Adresa elektronike: _____ Nr. tel: _____	Data: __/__/201__ Nënshkrimi: _____
--	--	--

Autoriteti publik:

Adresa:

Qyteti:

Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar

Të tjera të dhëna

Forma që kërkohet informacioni / dokumentacioni: _____

Vetëm për përdorim zyrtar

Data e marrjes: __/__/201__	Numri rendor i kërkesës: _____	Komente: _____ _____ _____
-----------------------------	--------------------------------	----------------------------------

Informacioni në këtë format dhe të dhënat e ID do të përpunohen në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

¹ Në rastet kur informacioni i kërkuar përmban të dhëna personale, kërkohet dokumenti i identifikimit të kërkuesit.



- Adresa dhe kontaktet mund të gjenden nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik qeveritar *e-albania.al*, portalit *pyetshtetin.al* apo, kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik.

- Drejtoni kërkesën tuaj, koordinatorit për të drejtën e informimit, të institucionit që mban informacionin e kërkuar. Kontaktet e tij janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit. Ju mund të dërgoni një kërkesë edhe nëpërmjet portalit *pyetshtetin.al*.

- Kur ju mendoni se ju kanë mohuar ndonjë prej të drejtave tuaja në bazë ligjit, keni të drejtë të ankoheni tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

LIDHJA NR. 4 (Përgjigja)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
(DREJTORIA...)

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____ 2017

Lënda: Informacioni/dokumentacioni i kërkuar

Drejtuar: _____

Adresa:

Në cilësinë e kërkuarit keni depozituar pranë Entit Rregullator të Energjisë, në përputhje me nenin 11 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, kërkesën për dhënie informacioni, regjistruar me numër protokollit ____, datë ____/____/ 201__ .

Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni (përshkrim i akteve/informacioneve /dokumentacionit që kërkohet).

1. _____
2. _____
3. _____

KRYETARI



LIDHJA NR. 4/a



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
(DREJTORIA...)**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____ 2017

Lënda: Refuzim i formës së kërkuar të informacionit/dokumentacionit

Drejtuar: _____

Adresa:

Në zbatim të pikës 4 të nenit 14 të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, për arsye se (arsyetohet pse ERE nuk disponon (p.sh.) të tilla mjete/ aparate/ pajisje që bëjnë të mundur dhënien e dokumentacionit në formatin e kërkuar), ju refuzohet dhënia e tij në formën e kërkuar.

Ndaj refuzimit të kërkesës suaj mund të ankoheni pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me nenin 24/1,2/a të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

KRYETARI



LIDHJA NR. 4/b



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
(DREJTORIA...)**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____ 2017

Lënda: Zgjatja e afatit të kthimit të përgjigjes

Drejtuar: _____

Adresa:

Në zbatim të pikës 3 të nenit 15, të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, për arsye se (të evidentohet në përputhje me parashikimet në gjerat “a”, “b”, “c” të nenit 15/3) vendoset për zgjatjen e afatit të kthimit të përgjigjes me 5 ditë pune.

Ndaj mosnjoftimit të zgjatjes së afatit të shqyrtimit mund të ankoheni pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me nenin 24/1/2/a të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

KRYETARI



LIDHJA NR. 4/c



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
(DREJTORIA...)**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____ 2017

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurës për rishikim të dokumentacionit të klasifikuar dhe shtyrje të afatit

Drejtuar: _____

Adresa:

Në zbatim të pikës 5 të nenit 17, të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, ju njoftojmë se ka nisur procedura për rishikimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, në përputhje me ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror”, i ndryshuar.

Në këtë rast, afati për vlerësimin e dhënies së informacionit shtyhet (deri në 30 ditë pune).

KRYETARI



VENDIM

Nr. 113, datë 27.7.2017

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË
OPERATORI I SISTEMIT TË
TRANSMETIMIT OST SHA NË
AKTIVITETIN E TRANSMETIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, 37 pika 2, germa “b”, 38, 53 dhe 58, pika 1 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “e”; 5, pika 1, germa “e”; 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.7.2017, mbasi shqyrtoi relacionin mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit OST sh.a., në aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Shoqëria OST sh.a., me shkresën nr. dl.3864 Prot., datë 12.7.2017 ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike.

- Neni 58 i ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, parashikon që “Para se të licencohet për kryerjen e veprimtarisë së operimit të sistemit të transmetimit, Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të certifikohet sipas procedurës së përcaktuar në këtë nen”.

- Me vendimin nr. 43, datë 15.3.2017, bordi i ERE-s ka vendosur “Miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a., në përputhje me nenin 54, pika 6, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenin 9, pika 6, të direktivës 72/2009 EC.

Aplikimi i shoqërisë OST sh.a. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e

licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

Neni 9, pika 1:

- germa “a” (të dhënat për aplikim) plotësuar;
- germa “b” (të dhëna identifikuese për aplikuesit) plotësuar;
- germa “c” (të dhëna për aplikuesin) plotësuar.

Neni 9, pika 2:

- germat “a”/“b” (akti i themelimit/statuti) plotësuar;
- germa “c” (vërtetimi i regjistrimit nga QKB) plotësuar;

- germa “d” (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë) plotësuar;

- germa “e” (struktura e ndërtimit të shoqërisë) plotësuar;

- germa “f”, marrëveshje koncesioni ose autorizimi nga KM në rastet e aplikueshme në përputhje me kuadrin ligjor përkatës (kjo pikë e rregullores nuk gjen zbatim për këtë aktivitet);

- germa “g” dokumente që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (kontrata shitblerje, kontrata qiraje, akte dhurimi, kontrata premtim shitblerje, marrëveshje me subjektet që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti për ato veprimtari që përdorin asete për kryerjen e aktivitetit të licencuar) plotësuar. (Subjekti ka depozituar në ERE certifikatat përkatëse të pronësisë.)

Neni 9, pika 3:

- germa “a” (vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave) plotësuar;

- germa “b” (bilanci financiar i tre viteve të fundit) plotësuar;

- germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit) plotësuar;

- germa “d” (vërtetimin e pagesës së regjistrimit për aplikim në llogari të ERE-s) plotësuar.

Neni 9, pika 4.5 - Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e transmetimit të energjisë elektrike:

- Germa “a”. Të dhëna për linjat e transmetimit – plotësuar.

- Germa “b”. Të dhëna për n/st e sistemit të transmetimit – plotësuar.

- Germa “c”. Të dhëna për konsumatorët dhe përdoruesit e lidhur në sistemin e transmetimit – plotësuar.

- Germa “d”. Të dhëna për energjinë që parashikohet të transmetohet – plotësuar.



- Germa “e”. Diagrami i sistemit të transmetimit që tregon elementet ekzistuese dhe ato të perspektivës në format A1 – plotësuar.

- Germa “f”. Planet e investimeve për përmirësimin, mirëmbajtjen dhe zgjerimin e sistemit të transmetimit – plotësuar.

- Germa “g”. Lista e të punësuarve, profesioni, formimi – plotësuar;

- Germa “h”. Lista e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës – plotësuar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit OST sh.a. në aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ANËTARI I BORDIT TË ERE-S
Adriatik Bego

VENDIM

Nr. 114, datë 27.7.2017

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBANIAN GREEN ENERGY” SHPK NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 37 pika 2, germa “ç” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “d”; 5, pika 1, germa “d”; 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.7.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licencimin e shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k. në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut;

konstatoi se:

ERE, me vendimin nr. 68, datë 11.5.2017, vendosi mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k. në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, duke qenë se u konstatua mungesa e dokumentacionit teknik, si dhe mungesa e pagesës së aplikimit për pajisje me licencën e furnizimit të energjisë elektrike.

ERE, më shkresën nr. 352/2 Prot., datë 22.5.2017, njoftoi subjektin “Albanian Green Energy” sh.p.k. për plotësimin e dokumentacionit të munguar.

Shoqëria “Albanian Green Energy” sh.p.k., me shkresën nr. 059 Prot., datë 6.6.2017, paraqiti në ERE brenda afateve të përcaktuara në nenin 10, pika 7 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dokumentacionin e munguar për të plotësuar aplikimin e tij, si dhe kreu pagesën e aplikimit për pajisjen me licencë furnizimi me energji elektrike.

Me vendimin nr. 102, datë 4.7.2017, bordi i ERE-s filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k. në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

Aplikimi i shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formatit i aplikimit (neni 9, pika 1, germa “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germa “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germa “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, germa “a”, “b”, “c”, “e”, “f”, “a1”, “b1”, “c1”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Albanian Green Energy” sh.p.k. në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ANËTARI I BORDIT TË ERE-S
Adriatik Bego

VENDIM

Nr. 115, datë 27.7.2017

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR
GARANCITË FINANCIARE TË
PJESËMARRËSVE PËR REGJISTRIMIN
NË TREGUN E ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; kapitullit III, pika III.2.4 të “Rregullave të Përkohshme të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike”, miratuar me vendimin nr. 139, datë 15.8.2016, të bordit të ERE-s; si dhe në zbatim të nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016; bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 27.7.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e “Draftregullores për garancitë financiare të pjesëmarrësve për regjistrimin në tregun e energjisë elektrike”, të përgatitur nga drejtoritë teknike,

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 6583 Prot., datë 18.10.2016, OST sh.a. ka dërguar në ERE kërkesën për miratimin e “Rregullave për garancitë financiare të pjesëmarrësve për regjistrimin në tregun e energjisë elektrike.”

- ERE, me vendimin nr. 3, datë 19.1.2017, filloi procedurat për miratimin e “Rregullave për garancitë financiare të pjesëmarrësve për regjistrimin në tregun e energjisë elektrike”.

- ERE, me shkresën nr. 90 Prot., në datë 26.1.2017, ka ftuar palët e interesuara të shprehin opinionet dhe komentet e tyre në lidhje me “Draftregullat për garancitë financiare të pjesëmarrësve për regjistrimin në tregun e energjisë elektrike”.

- Autoriteti i Konkurrencës, me shkresën me nr. 32/1 Prot., datë 23.2.2017, dhe OSHEE sh.a., me shkresën nr. 2742/1 Prot., datë 10.2.2017, kanë përcjellë në ERE sugjerimet dhe komentet e tyre në lidhje me Draftregullat për garancitë financiare të pjesëmarrësve për regjistrimin në tregun e energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE

VENDOSI:

1. Të miratojë “Rregullat për garancitë financiare të pjesëmarrësve për regjistrimin në tregun e energjisë elektrike”(bashkëlidhur).

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OST sh.a., KESH sh.a., OSHEE sh.a., Autoritetin e Konkurrencës, MEI dhe palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ANËTARI I BORDIT TË ERE-S
Adriatik Bego

**RREGULLAT PËR GARANCITË
FINANCIARE TË PJESËMARRËSVE
PËR REGJISTRIMIN NË TREGUN E
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Kapitulli I

Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Autoriteti

Këto rregulla hartohen dhe miratohen në zbatim të pikës III.2.4 të “Rregullave të Përkohshme të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike”, të miratuara me vendimin nr. 139, datë 15.8.2016, të bordit të ERE-s, të ndryshuar.



Neni 2 Qëllimi

Qëllimi i këtyre rregullave është të përcaktojnë procedurat për garancitë financiare që çdo pjesëmarrës në tregun e energjisë elektrike (TEE) duhet të sigurojë për llogari të OST-së për shërbimin e transmetimit përpara se të regjistrohet në TEE.

Neni 3 Përcaktime dhe shkurtime

1. ERE – Enti Rregullator i Energjisë është autoriteti rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, i cili funksionon në përputhje me ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”.

2. TEE – Tregu Shqiptar i Energjisë Elektrike – është një sistem ku kryhen shitje dhe blerje efektive, përfshirë edhe derivatet e energjisë elektrike, nëpërmjet kërkesave dhe ofertave, të paraqitura në perioda afatgjata dhe afatshkurtra, referuar ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

3. OST – Operatori i Sistemit të Transmetimit është personi juridik përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike, i licencuar nga ERE.

4. Operatori i Tregut - Struktura përgjegjëse e licencuar për operimin, organizimin dhe menaxhimin e tregut të energjisë elektrike, që aktualisht është pjesë e OST-së.

5. Marrëveshje e pjesëmarrjes në treg – një dokument që rregullon marrëdhëniet ndërmjet palëve që e nënshkruajnë atë, OST-OT dhe pjesëmarrësit në tregun e energjisë elektrike duke përcaktuar detyrimet dhe të drejtat që rrjedhin nga veprimtaria e tyre në tregun e energjisë.

6. Pjesëmarrësi i tregut të energjisë elektrike – është një person juridik, i regjistruar si pjesëtar i tregut të energjisë elektrike, që përfshin: prodhuesit, tregtarët, furnizuesit, klientët, Operatorin e Sistemit të Transmetimit, Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes, sistemet e mbyllura të shpërndarjes dhe Operatorin e Tregut, mbajtës të licencës të lëshuar nga ERE.

7. Garanci financiare do të thotë një angazhim në një bankë për të mbuluar dhe siguruar përmbushjen në mënyrë të besueshme të

detyrimeve financiare të pjesëmarrësit në tregun ndaj OST-së.

Kapitulli II Informacioni teknik dhe garancia financiare për regjistrimin në tregun e energjisë elektrike

Neni 4 Informacioni teknik

1. Në mbështetje të Marrëveshjes për Pjesëmarrje në Treg, çdo pjesëmarrës në tregun e energjisë elektrike do të ofrojë për Operatorin e Tregut informacionin teknik në vijim, në aneksin e kësaj rregullore.

2. Dokumentacioni, sipas rastit, është origjinal ose fotokopje e noterizuar.

3. Ky informacion është kusht për regjistrim në tregun e energjisë elektrike.

Neni 5 Depozitimi dhe përdorimi i garancisë financiare

1. Çdo subjekt i regjistruar në Tregun Shqiptar të Energjisë Elektrike (TEE) do të depozitojë, në një bankë tregtare të krijuar në Shqipëri, një garanci financiare në lekë. Garancia financiare është një parakusht për pjesëmarrjen në TEE.

2. Pjesëmarrësi në TEE do të njoftojë OST-në për depozitimin e garancisë financiare jo më vonë se 15 ditë pune përpara se programi fizik i parashikuar nga pjesëmarrësi në TEE të bëhet efektiv, në mënyrë që të lejojë OST-në të verifikojë që garancia është vënë.

3. Një pjesëmarrës i TEE-së do të autorizojë OST-në që të përdorë sasinë e garancisë për pagesa ose transfertat për OST-në pa miratimin paraprak të tij, përveçse kur pjesëmarrësi ka paraqitur brenda 7 ditëve pune nga njoftimi i OST-së për përdorimin e garancisë, një ankesë në ERE që arsyeton përse OST-ja nuk duhet të përdorë garancinë.

4. OST-ja do të njoftojë pjesëmarrësin 10 ditë pune më përpara për përdorimin e garancisë financiare, arsyen për përdorimin e saj (si p.sh., detyrimet e papaguara ndaj OST-së), si dhe për datën e ekzekutimit të garancisë financiare.

5. OST-ja do ta përdorë garancinë financiare të një pjesëmarrësi të TEE-së për të përmbushur detyrimet që ky i fundit ka ndaj OST-së.



6. Shuma e garancisë financiare do të jetë e barabartë me 5% të programit fizik mujor të parashikuar nga pjesëmarrësi në TEE shumëzuar me 10 lekë/kWh, por jo më shumë se 20 milionë lekë dhe jo më pak se 500 mijë lekë, në përputhje dhe në plotësim të rregullave të tregut.

7. OST-ja do të humbasë të drejtën për të përdorur garancinë financiare të një pjesëmarrësi të TEE-së mbas njoftimit të çregjistrimit të pjesëmarrësit nga TEE-ja, siç parashikohet në Rregulloren për procedurat e regjistrimit në tregun e energjisë elektrike.

8. Mbas njoftimit të çregjistrimit të pjesëmarrësit nga TEE-ja, siç parashikohet në Rregulloren për procedurat e regjistrimit në tregun e energjisë elektrike, OST-ja ka të drejtë të prekë nga garancia financiare atë pjesë që i korrespondon detyrimit financiar të prapambetur të pjesëmarrësit ndaj OST-së.

9. Çdo detyrim i prapambetur i pjesëmarrësit në TEE pasi ai është çregjistruar nga TEE-ja, për të cilën OST-ja ka prekur garancinë financiare, siç përcaktohet në paragrafin më sipër në këtë pikë, mund të jetë objekt i kërkimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 6

Ankimi mbi përdorimin e garancisë financiare

1. Një pjesëmarrës që kundërshton përdorimin e garancisë financiare nga OST-ja mund të paraqesë një ankesë në ERE brenda 7 ditëve pune nga dita e marrjes së njoftimit të OST-së lidhur me përdorimin e garancisë financiare, duke vënë në dijeni edhe OST-në për ankesën e paraqitur në ERE.

2. Nëse një pjesëmarrës paraqet një ankesë sipas pikës 1 të këtij neni, OST-ja nuk do ta përdorë garancinë deri kur të lejohet ta bëjë një gjë të tillë nga ERE ose mbas 30 ditëve pune nga paraqitja e ankesës, nëse ERE nuk ka vepruar brenda afateve kohore të përcaktuara në këto rregulla, ERE do të marrë një vendim për ankesën e paraqitur, i cili do të jetë i detyrueshëm për zbatim nga OST-ja.

3. Vendimi i ERE-s mund të apelohej nga pjesëmarrësi në TEE ose OST në gjykatën administrative brenda 30 ditëve kalendarike nga publikimi i vendimit në Fletoren Zyrtare.

Kapitulli III

Dispozita të fundit

Neni 7

Amendime të Rregullores

Këto rregulla janë objekt i rishikimit dhe ndryshimit me vendim të bordit të ERE-s, të propozuara nga OST-ja, në përputhje me Rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Këto rregulla hyjnë në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr. 116, datë 27.7.2017

MBI KËRKESËN PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT TË ERE-S NR. 148, DATË 26.12.2014, PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMEVE TË SHITJES ME PAKICË TË ENERGIJË ELEKTRIKE PËR KONSUMATORËT TARIFORË PËR VITIN 2015

Në mbështetje të nenit 16, pika 5 dhe 6 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 8 dhe 16 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2017, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.7.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, mbi rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 148, datë 26.12.2014, për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë për vitin 2015,

konstatoi se:

- Në ERE, me shkresën nr. 525 Prot., datë 24.4.2017, është protokolluar kërkesa e Telecom Albania sh.a., Vodafone Albania sh.a., Plus Communication sh.a. dhe Albtelecom sh.a., për rishikimin e vendimit nr. 148, datë 26.12.2014, të ERE-s, ku të shtohet një kategori e veçantë në këtë vendim për operatorët e shërbimeve publike të komunikimeve elektronike dhe të zbatohen tarifa për këta sipërmarrës me nivele më të ulëta se tarifatat që aplikohen aktualisht, dhe në çdo rast jo më shumë se 9.5 lekë/KWh.



- Me vendimin nr. 148, datë 26.12.2014, është vendosur: “Për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë për vitin 2015”.

- Me vendimin nr. 190, datë 22.12.2016, është vendosur mbi lënien në fuqi të vendimeve nr. 139, nr. 145, nr. 146, nr. 147, nr. 148, datë 26.12.2014, të bordit të komisionerëve të ERE-s, vendimit nr. 13, datë 16.2.2016, vendimit nr. 128, datë 29.7.2016, të bordit të ERE-s deri në 31.3.2017.

- Me vendimin nr. 52, datë 6.4.2017, është vendosur mbi lënien në fuqi të vendimit nr. 190, datë 22.12.2016, të bordit të ERE-s, deri në 31.12.2017.

- Neni 16, pika 5 e ligjit 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” parashikon që: “Çdo palë e përfshirë në një procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit lidhur me atë procedurë, rishikimin e vendimit të bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet materiale të konstatuara”.

- Kërkesa për rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 148, datë 26.12.2014, është përcjellë jashtë afateve të parashikuara në ligj e si e tillë është parashkruar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së shoqërive Telecom Albania sh.a., Vodafone Albania sh.a., Plus Communication sh.a. dhe Albtelecom sh.a., për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 148, datë 26.12.2014, “Për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë për vitin 2015”.

2. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ANËTARI I BORDIT TË ERE-S
Adriatik Bego

VENDIM

Nr. 117, datë 27.7.2017

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË OSHEE SHA PËR MIRATIMIN E PËRFUNDIMIT TË KONTRATËS SË SHITBLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE ME SHOQËRINË “STAR NRG” SHPK, NË MËNYRË TË NJËANSHME

Në mbështetje të neneve 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 14 të kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike, të miratuar nga bordi i ERE-s me vendimin nr. 101, datë 23.6.2016, dhe nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.7.2017, mbasi shqyrtoi relacionin mbi kërkesën e shoqërisë OSHEE sh.a., për miratimin e përfundimit të kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike me shoqërinë “Star NRG” sh.p.k., në mënyrë të njëanshme, të përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

- Shoqëria OSHEE sh.a., me shkresën nr. 13983 Prot., datë 31.5.2017, ka paraqitur pranë ERE-s, kërkesën për miratimin e përfundimit të kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike me shoqërinë “Star NRG” sh.p.k. në mënyrë të njëanshme.

- Shoqëria “Star NRG” sh.p.k., me shkresën nr. 27 Prot., datë 3.6.2017, ka paraqitur pranë ERE-s, kërkesën për mosmiratimin e përfundimit të kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike me shoqërinë “Star NRG” sh.p.k. në mënyrë të njëanshme, të kërkuar nga shoqëria OSHEE sh.a.

- Shoqërisë “Star NRG” sh.p.k., në mënyrë të përsëritur, i është bërë me dije se nuk është subjekt i trajtimit nga ERE për shkak të mos qenit subjekt i licencuar, ndaj kërkesa e saj për trajtim nga ERE është e pambështetur në ligj.

- Shoqëria “Star NRG” sh.p.k. në kuptim edhe të kontratës sa më sipër nuk ka kontratë shitblerje të HEC-eve, për të cilat pretendon se ka vetëm kontratë qiraje nga blerësi “Projeksion Energji” sh.a. Kjo kontratë, për shkak të mungesës së autoritetit ligjor të administratorit të shoqërisë “Projeksion Energji” sh.a. dhe vendimit të gjykatës sipërcituar, është nul.



- Shoqërive “Star NRG” dhe “Projeksion Energji” sh.a. u është thënë në mënyrë të përsëritur që HEC-et, për të cilat ka licencë shoqëria “Projeksion Energji” sh.a., nuk mund t’u tjetërsohen palëve të treta, nëse nuk nënshkruhet kontrata nga të dy aksionerët e shoqërisë.

- Gjykata është shprehur me vendim për ndalimin e aksionerit të “Projeksion Energji” sh.a., z. Anastas Riska, që të sillet si administrator i shoqërisë “Projeksion Energji” sh.a. Rezulton që kontrata e qirasë mes “Projeksion Energji” sh.a. dhe “Star NRG” sh.p.k. të jetë nënshkruar nga aksioneri sa më sipër.

- Edhe për ERE-n, kontrata mes z. Anastas Riska dhe “Star NRG” sh.p.k. është nul për sa më sipër, dhe kjo i është bërë me dije në korrespondencë zyrtare OSHEE sh.a., “Projeksion Energji” sh.a. dhe “Star NRG” sh.p.k.

- Shoqëria “Star NRG” sh.p.k. nuk është subjekt i licencuar nga ERE e mbështetur në “Rregulloren për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, të miratuar nga bordi i ERE-s, nuk është objekt trajtimi nga kjo e fundit.

- Nëse nuk ka kontratë që të dëshmojë titull pronësie/të drejtë shfrytëzimi mbi një HEC, nuk mund të konsiderohet shoqëri tregtare që ushtron aktivitet në sektorin e energjisë elektrike, pra prodhues.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë OSHEE sh.a. për përfundimin e njëanshëm të kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike të lidhur mes OSHEE sh.a. dhe “Star NRG” sh.p.k., me nr. 20560/1, datë 21.9.2016.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ANËTARI I BORDIT TË ERE-S
Adriatik Bego

VENDIM

Nr. 119, datë 27.7.2017

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENERGY FINANCING TEAM TIRANA” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “e”; 5, pika 1, germa “e”; 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 15 të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.7.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

ERE, me vendimin e bordit nr. 104, datë 10.7.2017, ka filluar procedurat për licencimin e shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

Aplikimi i shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formatit i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat (“a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni tekniko-ekonomik (neni 9, pika 4.8, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ANËTARI I BORDIT TË ERE-S
Adriatik Bego

VENDIM

Nr. 120, datë 27.7.2017

**MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMEVE TË
BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE,
TË PRODHUAR NGA BURIMET E
VOGLA GJENERUESE FOTOVOLTAIKE,
ME KAPACITET TË INSTALUAR DERI
NË 2 MW, DHE EOLIKE ME
KAPACITET TË INSTALUAR DERI NË 3
MW**

Në mbështetje të nenit 10, pika 2 dhe 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 10, pika 3 të ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike, të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”, nenit 22 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.7.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike, në lidhje me “Përcaktimin e çmimeve të blerjes së energjisë elektrike, të prodhuar nga burimet e vogla gjeneruese fotovoltaike me kapacitet të instaluar deri në 2 MW, dhe eolike me kapacitet të instaluar deri në 3 MW”,

konstatoi se:

- ERE ka detyrimin e përcaktimit të çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era, në bazë të nenit 10, pika 3 të ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”.

- VKM nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”, në pikën 2 të tij, ngarkon ERE-n me miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era, në përputhje me çmimin e mesatarizuar për vitin 2017, sipas parashikimeve të kësaj metodologjie.

- Me vendimin nr. 89 datë 7.6.2017, bordi i ERE-s ka vendosur për fillimin e procedurës “Për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”.

- Në vijim ERE, mbasi shqyrtoi VKM-në nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era, formuloi një sërë pyetjesh për sqarimin e kësaj metodologjie të cilat ia adresoi Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë për sqarim.

- Ministria e Energjisë dhe Industrisë, me shkresën e saj nr. 4445/1 Prot. datë 4.7.2017, dërgoi në ERE-n sqarimet si më poshtë:

- Gjykojmë se LCOE ka të njëjtën formulë për të gjitha teknologjitë gjeneruese, si nga burime të rinovueshme, ashtu edhe ato fosile. Po kështu, LCOE llogaritet me të njëjtat variabla dhe me të njëjtat praktika ndërkombëtare të së njëjtës fushë: gjenerimin e energjisë në impiantin gjenerues, i cili merr në konsideratë kostot e kapitalit, kohën e vetëshlyerjes, shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtjes, si edhe kostot e lëndës djegëse. Në këtë kuptim, VKM-ja referon këtë formulë, e cila është universale për LCOE-në dhe këto janë bazat e metodologjisë:

- praktikat me të mira të përcaktimit të LCOE-së dhe

- propozimin e formulës llogaritëse ose algoritmit bazuar mbi këto praktika.

- Metodologjia e propozuar përmban elementet bazë të saj: (i) sistemin e rregullave dhe



parimeve; (ii) metodën e llogaritjes dhe (iii) objektin konkret që ka të bëjë me impiantet PV dhe eolike, përkatësisht 2 MW dhe 3 MW, dhe është sipas të gjitha praktikave metodologji për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike nga impiante të vogla gjeneruese me burime të rinovueshme.

- Metodologjia e propozuar është për objektin konkret: Impiante fotovoltaike deri në 2 MW dhe impiante eolike deri në 3 MW, duke iu përmbajtur nenit 10, pika 3.

- Aktualisht, në Shqipëri nuk ka investime të kësaj natyre të impianteve me diell (PV) apo me erë (eolik), dhe për këtë arsye ka një mungesë të theksuar të të dhënave lidhur me planet e biznesit dhe kostot shoqëruese, me qëllim kryerjen e një analize të saktë të kostove në kushtet e vendit tonë. Informacioni që disponojmë nga propozime të pakërkua është se ka një shumëllojshmëri analizash dhe kostosh, të cilat asnjëherë nuk kanë proceduar në investim konkret. Në këto kushte, referencat janë të bazuara në studimet që disponohen, dhe mbi bazën e këtyre studimeve rezultojnë se orët e punës së impianteve me diell ndryshojnë nga ato me erë dhe ky faktor përbën edhe ndryshimin në llogaritjen e çmimit për të dyja impiantet, megjithëse WACC rezultojnë i njëjtë.

- Në vijim të praktikës, ERE organizoi një seancë teknike dëgjimore më datë 10.7.2017 me përfaqësues të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, në lidhje me zbatimin e VKM-së 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”.

- Në përfundim të seancës dëgjimore, nga përfaqësuesit e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë u bë me dije:

- Objekti i metodologjisë është përcaktimi i çmimit të blerjes së energjisë elektrike nga impiante të vogla gjeneruese me burime të rinovueshme deri në 2 MW me fotovoltaike dhe deri në 3 MW instalime me impiante eolike. Kjo metodologji reflekton politikën energjetike të Këshillit Ministrave, në përputhje me parashikimet e vendosura nga legjislativi përkatës.

- Duke qenë se nuk ka eksperiencë të tjera apo të dhëna mbi kostot reale të projekteve,

çmimi i referuar si i mesatarizuar në metodologji duhet t'i shërbejë ERE-s gjatë vendimmarrjes për vitin 2017.

- Nëse ERE gjatë zbatimit të këtyre çmimeve përgjatë vitit 2017 vëren luhajtje, mospërputhje dhe paqartësi, ajo mund të bëjë propozime konkrete për përmirësimin dhe rishikimin e metodologjisë për periudhën në vazhdim.

- Në bazë të propozimit të metodologjisë së miratuar nga KM-ja, duke marrë parasysh mungesat e të dhënave lidhur me kostot e investimit dhe operimit të teknologjive fotovoltaike dhe eolike në vend, mungesa e eksperiencave të mëparshme për incentivimin dhe mbështetjen e investimeve në këtë fushë, si dhe duke bërë një krahasim me çmimet e rajonit për këto burime, për të mundësuar nxitjen e investimeve në këto teknologji, ERE, mbasi shqyrtoi VKM-në nr. 369 datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era” dhe relacionin argumentues të metodologjisë, merr në konsideratë:

- riskun e vendit;

- riskun e politikave energjetike për nxitjen e burimeve të rinovueshme;

- gjetjet e studimit të IRENA-s për llogaritjen e LCOE-së për Shqipërinë, të marrë në konsideratë nga VKM-ja nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”, për një afat 15-vjeçar, që parashikohet t'u jepet burimeve të energjive të rinovueshme në Shqipëri sipas ligjit 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”.

- Në vijim përgjatë kësaj periudhe, me shkresën nr. 255/1, datë 19.7.2017, Autoriteti i Konkurrencës, në përgjigje të shkresës së ERE-s nr. 453 Prot, datë 13.6.2017, me të cilën është dërguar vendimi i ERE-s nr. 89, datë 7.6.2017, për opinion, shprehet se Autoriteti i Konkurrencës, pasi shqyrtoi vendimin e ERE-s, konkludoi se:

- do të shprehet pasi të marrë informacionin e plotë, të saktë dhe të qartë, sipas kërkesës së pikës 2 të vendimit;



- përgjatë këtij procesi duhet të merret në konsideratë vendimi i Autoritetit të Konkurrencës nr. 408, datë 21.3.201 “Për disa rekomandime për Entin rregullator të Energjisë mbi draftmetodologjinë e tarifës fikse të energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”.

- Nga ana jonë u vijua komunikimi me shkresën nr. 453/2, datë 25.7.2017, ku iu dërguan kërkesat tona drejtuar MEI-it, si dhe shkresa e MEI-it nr. 4445/1, datë 4.7.2017.

- Në përfundim të këtij komunikimi, Autoriteti i Konkurrencës, me shkresën nr. 453/3, datë 27.7.2017, përcolli në ERE qëndrimin e tij, duke u shprehur se: I konsideron të përshtatshme parashikimet e VKM-së nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”.

- Me qëllim mbledhjen e të dhënave sa më plotësuese, ERE ngriti një grup pune, i cili kreu një monitorim në impiantin PV në UKKO për marrjen e informacioneve në lidhje me kostot e investimit, O&M, shpenzime pune, si dhe kostot financiare e orët e punës me kapacitet të plotë.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Për vitin 2017, çmimi për të gjithë kontraktuesit e ndërtimit të impianteve të jetë:

a) për burimet e energjisë PV (fotovoltaikët) në vlerën 100 euro/MWh;

b) për burimet e energjisë nga era (eolike) 76 euro/MWh.

2. Duke filluar nga viti 2018, për investimet në vijim, ERE, në bazë të grumbullimit të të dhënave, për sa i përket kostove reale të investimit, nëse rezultojnë të ndryshme nga parashikimet e VKM-së nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”, t’i propozojë MEI-t për përmirësimin dhe rishikimin e VKM-së.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ANËTARI I BORDIT TË ERE-S
Adriatik Bego

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja KRISTALINA
Tiranë, 2017

Çmimi 224 lekë